

VENDIM
Nr. 672, datë 12.11.2025

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË SISTEMIT TË INTEGRUAR MJEDISOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të nenit 45, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Integruar Mjedisor (në vijim “SIM”).

2. Institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore SIM është Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

3. Të dhënat e bazës së të dhënave shtetërore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ndahen në të dhëna parësore e dytësore, si më poshtë vijon:

3.1. Të dhënat parësore konsiderohen të dhënat e mbledhura nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, që kanë të bëjnë me:

a) të dhënat për informacionin financiar, që lidhen me tarifat vjetore për lejet e tipit “A” dhe “B”;

b) të dhënat për raportet e vetëmonitorimit;

c) të dhënat për Regjistrin e Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve (në vijim “RSHTN”);

ç) të dhënat për inventarin e gazeve me efekt serrë;

d) regjistrin për operatorët e substancave ozonholluese, autorizimet e kuotave vjetore të importit e substancave ozonholluese dhe raportimin vjetor nga subjektet e licencuara e të autorizuar për importin e substancave ozonholluese;

dh) regjistrin e operatorëve të pajisur me kod unik për transferimin e mbetjeve;

e) informacionin mbi dëgjesat publike;

ë) regjistrin e transfertave të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme;

f) regjistrin e eksportit të mbetjeve të rrezikshme e jo të rrezikshme dhe transit të mbetjeve të rrezikshme e inerte;

g) regjistrin e autorizimeve për eksport dhe transit të mbetjeve;

gj) regjistrin për sipërmarrësit e licencuar e të autorizuar për importin e gazeve serrë të fluoruara dhe të pajisjeve, që funksionojnë me gaze serrë të fluoruara, autorizimet për pajisjen me kuotë vjetore importi, si dhe raportimet vjetore nga subjektet e licencuara e të autorizuar;

h) regjistrin për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë (në vijim “MRVA”), i cili përfshin informacionin për autorizimet për shkarkimin e GES-it, planet e monitorimit dhe raportet vjetore të shkarkimeve nga verifikues të akredituar.

3.2. Të dhënat dytësore konsiderohen të dhënat, që merren nga ndërveprimi me bazën e të dhënave shtetërore, si:

a) të dhënat e licencave, autorizimeve dhe lejeve të subjektit nga Regjistri Kombëtar i Licencave dhe Autorizimeve/Qendra Kombëtare e Biznesit;

b) të dhënat e përgjithshme të subjektit nga Regjistri Tregtar/Qendra Kombëtare e Biznesit;

c) të dhënat e lejes së ndërtimit/zhvillimit nga data bazë e lejes së ndërtimit (*e-Leje*)/Agjencia e Zhvillimit të Territorit;

ç) të dhënat për inspektimet nga *e-Inspektimi*/Inspektorati i Përgjithshëm;

d) të dhënat e shtresave bazë ortofoto gjeohapësinore, që përfshijnë koordinata dhe *shapefile* nga Gjeoportali Kombëtar/Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor;

dh) të dhënat për kimikatat nga Regjistri Elektronik i Kimikateve/Zyra e Kimikateve;

e) të dhënat e gjenealiteteve të individëve nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile/Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

ë) të dhënat e deklaratës doganore nga sistemi i autorizuar i të dhënave doganore/Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

f) të dhënat për mbetjet urbane të ardhura nga çdo njësi e vetëqeverisjes vendore;

g) raportimi nga ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, sipas formatit të shtojcës 2 të vendimit nr. 687, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në lidhje me statistikat e mbetjeve.

4. “Dhënësit e informacionit” për sistemin SIM janë:

a) subjektet e pajisura me leje mjedisore, licenca dhe VNM;

b) ministria përgjegjëse për mjedisin;

c) njësitë e vetëqeverisjes vendore;

ç) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

d) institucionet mbështetëse, të cilat kontribuojnë me të dhënat dytësore, sipas nënpikës 3.2 të këtij vendimi;

dh) Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve;

e) ministria përgjegjëse për shëndetësinë;

ë) ministria përgjegjëse për bujqësinë;

f) ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë.

5. “Subjekte të interesuara” për sistemin SIM janë subjektet apo institucionet e interesuara, që kanë të drejtën për informim, sipas legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit dhe të atij për inspektimin, si dhe legjislacionit për të drejtën për informim e të atij për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.

6. Niveli i aksesimit të sektorëve të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe institucioneve të linjës në sistemin SIM është, si më poshtë:

a) Sektori i shqyrtimit teknik për veprimtaritë në mjedis (leje mjedisore/licencat), si përditësues;

b) Sektori i shqyrtimit teknik të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM), si përditësues;

c) Sektori i monitorimit të lejeve mjedisore dhe VNM, si lexues, krijues, përditësues;

ç) Sektori i asistencës dhe i unifikimeve të proceseve mjedisore, si përditësues;

d) Sektori i menaxhimit të kimikateve, si përditësues;

dh) Sektori i informacionit, statistikave mjedisore dhe GIS, si përditësues;

e) Sektori i inspektimit të lejeve mjedisore dhe VNM, si lexues;

ë) Sektori i financës, i buxhetit, i mbledhjes së tarifave dhe identifikimit të debitorëve, si krijues;

f) Ministria e Mjedisit, në ushtrim të funksionit të saj politikëbërës e mbikëqyrës për politikat mjedisore, ka akses të plotë dhe funksional në të gjithë përmbajtjen e sistemit SIM, përfshirë të dhënat parësore e dytësore. Ministria është e pajisur me përdorues me profil të dedikuar për sektorin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, si përditësues, si dhe me përfaqësues nga Drejtoria e Ekonomisë Qarkulluese dhe Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike, si lexues;

g) Agjencitë rajonale të mjedisit përkatëse, në territorin e të cilave do të ushtrohet veprimtaria, si mendimdhënës;

gj) Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, si mendimdhënës;

h) Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve, si mendimdhënës;

i) Njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse, në territorin e të cilës do të ushtrohet veprimtaria, si mendimdhënës;

j) Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si mendimdhënës;

- k) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si mendimdhënës;
- l) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si mendimdhënës;
- ll) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, si mendimdhënës;
- m) Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, si mendimdhënës;
- n) Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, si mendimdhënës;
- nj) Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, si mendimdhënës.

7. Organizimi dhe funksionimi i brendshëm i sistemit dhe i bazës së të dhënave të SIM-it përcaktohen e miratohen me rregullore të brendshme të institucionit administruar, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”.

8. Të dhënat personale në regjistër dhe ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave shtetërore përpunohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, duke zbatuar masa të përshtatshme teknike e organizative për të garantuar integritetin, konfidencialitetin dhe gjurmueshmërinë e çdo veprimi mbi të dhënat personale. AKM-ja duhet të mbajë një regjistër të veprimeve të përpunimit e të garantojë auditim periodik të sistemit.

9. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe drejtoritë rajonale të saj, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Inspektorati i Përgjithshëm dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku